

SALAJDIN SALIHI POLLOGU SIPAS GJORÇE PETROVIT

929Petrov, Gj
811.18'373.21(497.75)

Abstrakti: Gjorçe Petrovi në librin e tij voluminoz për Maqedoninë, që u botua në vitin 1896, ofron të dhëna për hidrografinë, demografinë, gjeografinë, historinë, etnografinë, kulturën, arsimin, jetën religjioze të Maqedonisë, përfshirë Pollogun, me dy kryeqendrat e tij: Tetovën dhe Gostivarin. Pollogu përshkruhet si rajon me klimë të mirë, me ajër të pastër, ku përdoreshin tri gjuhë: turqishtja, shqipja dhe bullgarishtja, por më e respektuara ishte gjuha shqipe, që sipas autorit edhe turqit e *"flisnin më shumë se sa gjuhën e tyre amtare"*. Në këtë libër autori jep të dhëna për shumicën e katundeve të Pollogut.

Fjalët kyçe: Gjorçe Petrovi, Pollogu, Tetova, Gostivari

Gjorgje Petrovi (1864 - 1921), ishte publicist, profesor dhe historian, që u shkollua në Prilep, Manastir, Selanik dhe Plovdiv dhe punoi si mësues në Shtip e Shkup. Ai ishte pjesëtar i grupimeve revolucionare dhe bashkëpunëtor i disa revistave të kohës. Dyshohet se u vra me urdhër të Todor Aleksandrovit, pas përçarjes brenda VMRO.

Libri i tij voluminoz për Maqedoninë, i botuar në Sofje, më 1896¹, ofron shumë të dhëna për hidrografinë, demografinë, gjeografinë, historinë, etnografinë, kulturën, arsimin, jetën religjioze të Maqedonisë, përfshirë Pollogun, me dy kryeqendrat e tij: Tetovën dhe Gostivarin. Autori, në këtë pjesë, shpesh bazohet te shënimet e udhëpërshkruesit Andrej Stojanov.

Në këtë libër voluminoz, me mbi 700 faqe, ka shumë pasaktësi dhe anshmëri, megjithatë ofrohet një imazh i përgjithshëm për jetën e banorëve në këtë periudhë kohore.

Pollogu përshkruhet si rajon me klimë të mirë, me ajër të pastër dhe rajon shumë i gjelbëruar. *"Nuk do të ishte e tepruar nëse thuhet se klima e Tetovës është më e mira në gjithë Turqinë Europiane"*.

Në Tetovë, sipas autorit, përdoreshin tri gjuhë: turqishtja, shqipja dhe bullgarishtja. Gjuha më e respektuar ishte shqipja, që turqit, sipas autorit, e *"flisnin më shumë se sa gjuhën e tyre amtare"*, kurse bullgarët obligoheshin që ta njihnin atë. Gjuha turke përdorej vetëm në qytet. Gjuhën bullgare e njihnin të gjithë, përveç *"shqiptarëve të egër të Sharrit dhe të Lubotenit"*, siç shkruan autori, i cili raportet ndërmjet kombeve i përshkruan si të mira.

Si shumë studiues sllavë edhe Petrovi mbron qëndrimin e autoriteteve bullgare kur shkruan se këto vise kishin qenë të banuara me shumicë bullgare, para se *"të vinin shqiptarët nga Arnautllëku, të ndihmuar nga pashallarët e Tetovës"*, qëllimi i të cilëve, sipas tij, kishte qenë që të *"paralizonin bullgarët miakë"*.

Përkundër faktit se në këtë studim ka njëanshmëri, sërish gjejmë të dhëna të shumta për Pollogun. Sipas autorit kazaja e Tetovës kishte 30 mijë banorë: bullgarë, shqiptarë, turq dhe romë, ku shqiptarët dhe turqit përbënin 1/2 e popullsisë, kurse bullgarët 2/5 e popullsisë, ndërkaq të tjerët ishin romë. Vetë qyteti kishte 8 mijë banorë, ku 2/3 ishin shqiptarë dhe turq dhe 1/3 bullgarë. Sipas

¹ Gjorçe Petrov, *Материали по изучване на Македонија*, Sofje, 1896.

tij dikur Tetova kishte qenë *“e pastër bullgare”*, të fisit miakë, por pastaj kishte filluar depërtimi i elementit shqiptar. “Turqit”, siç i quan banorët e besimit mysliman, banonin më shumë në luginë dhe në lagjet lindore të qytetit, kurse bullgarët në pjesën e epërme, atë perëndimore.

Autori fokusohet edhe te popullata shqiptare në Sharr dhe shkruan se ata shpesh përballeshin me sulmet grabitqare, ku si pasojë kishte të vrarë te të dy palët. Malësorët shqiptarë të Sharrit përherë reagonin kundër grabitësve. Katundet e Sharrit, kështu, shërbenin si mbrojtje për katundet fushore.

Në katundet e Sharrit, ku jetonte një shumicë shqiptare dhe një pakicë sllave, burim kryesor mbijetese ishte kurbeti, blegtoria dhe shitja e drunjve.

Autori e përshkruan pamjen dhe karakterin e njerëzve të Pollogut. Banorët e Pollogut i paraqet si racë e shëndoshë dhe e bukur, që pëlqenin të visheshin bukur dhe të harxhonin para për veshje. Sipas tij, në Tetovë mund të shihje edhe pleq të moshës 120 vjeçare, që ende punonin.

“Turqit janë të shëndetshëm, të lartë, të fuqishëm dhe të bukur, me një shikim paksa të egër dhe të frikshëm”, shkruan Petrov.

Meshkuj, zakonisht, vishnin çakshirë, mintanë e jelekë, kurse në kokë mbanin fesa e plisa. “Turkeshat” në ambiente publike mbanin ferexhe të zeza, kurse në shtëpi visheshin me çitjane dhe jelekë.

Në Tetovë, sipas traditave turke, më shumë adhuroheshin zeshkanet, kurse biondet kishin bukuri të natyrshme.

Në Tetovën e kësaj kohe kishte 10 xhami dhe katër teqe, prej të cilave njëra ishte shumë e pasur. Këtu e ka fjalën për Teqenë e njohur Harabati Baba. Gjithashtu kishte dy shkolla ruzhdije dhe 3 medrese me 600 nxënës. Të krishterët nuk kishin kishë, sepse kisha e vetme në qytet ishte djegur në vitin 1872. Të krishterët kishin një shkollë për meshkuj dhe një për femra, me katër mësues dhe tri mësuese dhe me 250 nxënës dhe 100 nxënëse. Në shkollën serbe kishte dy mësues dhe 60 deri 70 nxënës.

Kazaja e Tetovës, që kufizohej me kazanë e Prizrenit, të Shkupit, Kërçovës dhe Dibrës, përshkruhet si vend i pasur me pemë e perime, me mollët e njohura, *“të parat në Maqedoni”*, si dhe me mushmollat, arat, gështenjat, qershitë e shalqinj të shumë cilësorë, por edhe me produktet tjera ushqimore, në veçanti grosha e Tetovës.

Blegtoria ishte e zhvilluar në katundet në malin Sharr. Pasuria në Tetovë *“ishte në duart e turqve”*. Pashallarët dhe bejlerët gëzonin respekt në mesin e popullatës. Bullgarët merreshin me zanate, tregti dhe shkonin në kurbet. Për shkak të kurbetit raporti ndërmjet burrave dhe grave ishte 30 me 1 në favor të grave. Llogaritej se kishte 60 mijë kurbetçinj të vjetër e të rinj.

Shqiptarët shquheshin si mjeshtër shumë të mirë për prodhimin e pushkëve martina, *“që mund t’u konkurronin edhe atyre evropiane”*. Kishte 5 - 6 makina uji për prodhimin e pushkëve. Dikur armëtaria dhe farkëtaria kishin qenë shumë më të zhvilluara në Tetovë, por kishin pësuar rënie. Në Tetovë prodhoheshin edhe shumë veshje të mira për gra.

Tetova bënte tregti më shumë me Dibrën, Rekën, Kërçovën, Shkupin dhe Selanikun. Në relacionin Tetovë - Shkup qarkullonin 22 karroca udhëtarësh, që mbartnin mall, kryesisht këtë e bënin muhaxhirët.

Tetova importonte 15 mijë okë vaj, që blihej në Gostivar, i cili importohej nga Selaniku. Mollët dhe grosha, gjithsej 20 mijë okë, shiteshin në Shkup dhe Selanik, kurse pesë mijë okë mollë cilësore shiteshin në Stamboll. Gjithashtu eksportoheshin 40 mijë okë gështenja dhe ara. Leshi dhe pambuku bliheshin në Prishtinë, kurse në Manastir blihej lëkurë. Nga jashtë importoheshin veshje burrash dhe grash.

Në Tetovë kishte 300 dyqane të thjeshtë, kurse tregtia më shumë zhvillohej me Shkupin se sa me Prizrenin edhe pse administrativisht i takonte këtij të fundit. Tregtia me Prizrenin realizohej nëpërmjet Malit Sharr. Në Prizren, ku vepronte një konsull serb, ishte shumë e shprehur propaganda serbe.

Tetova përshkruhet si qytet shumë i pastër falë lumit. Shumica e rrugëve ishin të shtruara me kalldrëm. Shtëpitë e bullgarëve kishin oborre të vogla, kurse shtëpitë e "turqve" (shqiptarëve) ishin me oborre të gjera dhe plot me pemë. Tetova shquhej për përkushtimin ndaj pastërtisë. Autori shkruan se *"shtëpitë e Tetovës dalloheshin për pastërtinë shembullore"*.

Autori jep shumë të dhëna edhe për katundet e Pollogut, që ishin nën administrimin e Tetovës. Megjithatë, sikur Andrej Stojanovi, nuk jep shumë të dhëna për katundet e Malësisë së Sharrit, përveç ndonjë përshkrimi të përgjithshëm. Le të ndalemi te disa të dhëna kryesore që i ofron për katundet e Pollogut, ku, gjatë përshkrimeve, shihet edhe një ndjenjë e tij kundër shqiptarëve. Ai shpesh tenton që shqiptarët t'i paraqesë si popullatë e ardhur vonë në këto vise, edhe pse të dhënat historike flasin ndryshe.

Poroj - Përshkruhet si katund pranë të cilit rrjedh lumi, që nga autori quhet "Potok". Njihej për kultivimin e shalqinjve cilësorë.

Laca - Ishte çiflig, që kishte shumë kurbetçinj.

Gjerma - Katund shqiptar, që prodhonte shumë mollë dhe kumbulla të mira. Shumë banorë ishin në kurbet, ku punonin si bozaxhinj dhe hallvaxhinj.

Xhepçishti - Katund i ndarë në dy pjesë: atë shqiptare dhe bullgare. Prodhonte shumë qershia, gështenja, molla, kumbulla dhe shalqi shumë të mirë. Bullgarët shkonin më shumë në kurbet. Kishte një kishë shumë të vjetër.

Eduarca - Katund ku kishte shumë pemë, veçanërisht mollë. Banorët dilnin shumë pak nga katundi. Në Tetovë punonin si bukëpjekës.

Setolja - Katund ku banorët shquheshin si furrtarët më të mirë në rajonin e Tetovës. Ata ishin kultivues të mëdhenj edhe të pemëve të ndryshme.

Otunja – Katund me shumë pemë. Shiste shumë gështenja.

Neproshteni – Përshkruhet si katund bullgaro – shqiptar. Shqiptarët dhe bullgarët jetonin në lagje të ndara. Këtu mbledheshin shumë gështenja. Shqiptarët përshkruhen si grabitës.

Leshka - Përshkruhet si vend shumë i vjetër, ku kishte ekzistuar qyteti Legen me 77 kisha, prej të cilëve kishin mbetur vetëm katër. Autori thotë se aty ishte edhe vendi i quajtur Kasapnicë, ku kishte mbetje nga banjat e vjetra. Në Leshkë rridhte edhe ujë i ngrohtë, termal. Aty gjendet manastiri "Shën Athanasi". Sipas një mbishkrimi, që e përmend autori, manastiri ishte rindërtuar nga mitropoliti i Shkupit, me origjinë nga Leshka, i quajtur Nikanor. Në këtë manastir jetonin gjashtë murgesha. Aty ishin gjetur edhe mbishkrime nga koha e Car Dushanit. Leshka përshkruhet si vend shumë i bukur, me ujë të jashtëzakonshëm. Mbi manastir është "Kalaja". Sipas gojëdhënave këtu kishte shumë para, por askush nuk arriti t'i merrte për shkak se vendi ruhej prej dy qenve.

Varvara - Gjendet pranë vendit Plloçë mbi Leshkë, prej ku shihej e gjithë fusha e mrekullueshme e Tetovës. Në katund kishte shumë pemë, por pak tokë punuese. Banorët punonin si bukëpjekës në shumë qytete. Pranë katundit kishte një kishë të moçme.

Sllatina - Katund bullgaro - shqiptar, që prej Leshkës e ndan vetëm lumi. Prodhonte groshë cilësore, pemë dhe duhan të mirë. Përreth katundit kishte gjërmadha të kishave të vjetra. Në katund kishte një kishë dhe një xhami. Sipas autorit ishte interesant se në tre katundet: Leshkë, Varvarë dhe Sllatinë njerëzve u shfaqeshin gusha. Mbi këto katunde gjendet vendi i quajtur Vërtishtë, i mbuluar me një

bar të verdhë që autori e quan "zdravica". Nga gjethet dhe farat e këtij bari shfaqej gusha. Njerëzit besonin se farat i sillte lumi, ujin e të cilit e pinin banorët e këtyre katundeve.

Brezna - Gjendet një orë larg Sllatinës, pranë Ploçës, që quhet edhe Vërtishtë. Mbi katund ka shumë dru ahu dhe gështenje. Katundi jepte 60 okë gështenja dhe 60 okë molla. Mbi Breznë gjendet vendi që quhet Selishtë, që dikur kishte qenë *"i banuar nga latinët"*. Vërtishta ishte shkatërruar nga jeniçerët. Aty kishte një vend që banorët përreth e quanin *"jeniçer"*. Në afërsi të Breznës kishte burime me ujë të njelmët.

Tearca - Katund shqiptar dhe bullgar, ku kalonte rruga nga Tetova drejt Kaçanikut. *"Tearca është një katund i madh, si qytezë"*. Këtu kishte 40 dyqane, ku banorët e katundeve përreth blinin ushqimet dhe gjësendet e domosdoshme pa pasur nevojë të shkonin në Tetovë. Fusha përshkruhet si shumë cilësore dhe ndër më të bukurat në Tetovë, e cila jepte shumë drithë. Kishte dhjetë mullinj ku bluani grurin katundet përreth dhe kishte 20 punëtori shajaku. Tearca ishte njëri prej katundeve më të pasur në Tetovë. Petrov shkruan se shumë shqiptarë që jetonin në afërsi kishin filluar të vendoseshin aty, duke ndikuar në zgjerimin e katundit. Autori përmend gojëdhëna, sipas të cilave këtu, dikur, kishte vetëm 9 shtëpi: 3 shqiptare dhe 6 bullgare. Në kohën kur është shkruar libri, Tearca kishte 180 shtëpi. Në këtë vend prodhohej shumë drithë, groshë, gështenja dhe ara, që ishin më të mirat në Tetovë. Lumi e ndante katundin në dy pjesë: në pjesën e majtë jetonin shqiptarët, ndërkaq në të djathtën bullgarët. Shqiptarët, sipas autorit, kishin ardhur më vonë. Ai bie në kontradiktë me atë që kishte shkruar më lart, kur thotë se dikur kishte pasur vetëm nëntë shtëpi, Atëherë i bie se të gjithë, pa dallim, ishin të ardhur. Petrovi, si shumë autorë bullgarë dhe serbë, tenton që shqiptarët t'i paraqesë si ardhacakë. Qëllimi dihet: shqiptarët të mos kishin legjitimitet historik dhe territorial mbi këto vise. Sipas Petrovit një mëhallë quhej Përvenc, sepse këtu kishin ardhur shqiptarët e parë, *"që ishin ftuar nga pashallarët dhe bejlerët për ta dominuar elementin bullgar"*. Matlievcët thotë se ishin me origjinë nga Mati. Lagja Gllogji, me 16 shtëpi, ishte nga fshati i afërm Gllogja. Kara – beqarët ishin me origjinë nga Dibra e Poshtme, kurse Mehmetët nga Dibra. Gjithashtu kishte edhe lagje si Përshevcët, Veshallët dhe Jazhincët, që ishin të ardhur nga katundet në fjalë të Pollogut. Në Tearcë, sipas autorit, kishte edhe pak banorë të ardhur nga Anadoli, të cilët, sipas tij, aty ishin vendosur pas luftës me austriakët në Shkup.

Otushishta ose Otunia - Përshkruhet si katund bullgaro - shqiptar, 10 minuta larg Tearcës, pranë të cilit kalon lumi Bistrica. Katundi kishte një kishë dhe prodhonte shumë gështenja.

Përshevc - Katund shqiptar, i vendosur në anën e majtë të lumit Bistrica, ku kishte shumë ara cilësore. Në këtë katund kishte tri lagje, kurse rrugët ishin të shtruara me kalldrëm. Në Përshevc kishte edhe një urë druri mbi Bistricë.

Eloshniku - Katund bullgar, ku banorët merreshin me shitjen e drurit. Mbi katund kishte shumë stane barinjsh. Katundi kishte pak ara në fushën e Dobroshtit. Pranë katundit kishte rrënoja të një manastiri të vjetër. Sipas gojëdhënës, shkruan autori, katundi kishte qenë shumë më i madh, por ishte shkretuar nga murtaja. Nga epidemia kishte mbetur vetëm një banor i quajtur Stojko dhe tri vajzat e tij. Njëra ishte martuar me një latin. Nga kjo martesë kishte mbetur lagja "Latinët" (latini), e cila kishte 15 shtëpi. Vajza tjetër ishte martuar me një "mango" (*"sikurse i quajmë ciganët"*), që kishte 10 shtëpi, kurse 88 shtëpitë tjera autori i quan si të pastra bullgare.

Gllogja - Katund shqiptaro – bullgar, që jepte shumë produkte ushqimore, veçanërisht groshë dhe tërshërë. Katundi kishte një kishë.

Dobroshti - Katund shqiptaro - bullgar, *"i vendosur pranë fushës, por më afër malit, njëzet minuta larg Jelloshnikut dhe çerek ore larg Gllogjës"*. Katundi përshkruhet si vend pjellor. *"Vendi është i pasur, kurse"*

banorët e Dobroshtit, sikurse të Tearcës, shumë rrallë shkojnë në kurbet. Nëpër katund rrjedh lumi Ponika, që katundin e ndan në dy pjesë: atë lindore dhe perëndimore. Bullgarët, që janë më të paktë në numër, banojnë vetëm në njërin pjesë". Vendet përreth lumit thuhet se ishin plot me kopshte e livadhe, kurse në katund thuhet se kishte shumë pemë, veçanërisht gështenja, kumbulla, ara. Petrov shkruan se Dobroshti dikur kishte qenë i krishterë dhe kishte pasur vetëm shtatë shtëpi, por më vonë raporti i shtëpive kishte qenë 20 shtëpi shqiptare dhe 50 shtëpi bullgare. Sipas tij, shqiptarët e parë në këtë katund ishin "*kjallarët*", të ardhur nga Dibra. Pas kthimit nga lufta "*ata ishin vendosur në këtë katund*". Sipas autorit 30 shtëpi ishin nga ky fis, 30 shtëpi të tjera ishin me origjinë nga Luma, kurse pjesa tjetër ishin me origjinë nga katundet përreth.

Odri – Katund që gjendej 20 minuta mbi katundin Dobrosht.

Përca – Katund shqiptar, gjysmë ore mbi Odër, pranë majës Kartari. Banorët shitnin në Tetovë gështenja dhe dru zjarri.

Bellovishta - Katund bullgar me një han dhe një farkëtar.

Vratnica - Katund bullgar, me një kishë dhe një shkollë. Banorët merreshin me blegtori dhe me shitjen e drurit për ngrohje. Kultivoheshin pemët, veçmas kumbullat dhe mollët. Përshkruhet si një derë e Fushës së Tetovës. Këtu ishte shumë i shprehur shpirti i serbizmit dhe ku refuzoheshin mësuesit bullgarë.

Stara Sella - Katund bullgar, ku kishte një kishë, rrëzë Lubotenit. Banorët merreshin me përpunimin e drurit dhe prodhonin qerre.

Orasha - katund shqiptar, ku banorët dalloheshin, sipas autorit, për "*karakterin grabitës*". Për banorët e Orashës autori shkruante se ishin "*bullgarë të shqiptarizuar*". Pranë Orashës gjendej kalaja e Sobrit, një qyteti i vjetër. Në këtë vend, shkruan Petrov, ishin gjetur shpesh monedha të vjetra romake.

Rogaçeva - Katund bullgar dhe çiflig i pashait, prandaj "*ishte i mbrojtur nga sulmet e shqiptarëve*". Banorët merreshin me bujqësi dhe blegtori.

Jazhinca - Katund shqiptaro – bullgar. Banorët merreshin me bujqësi dhe blegtori. Dikur kishte qenë vetëm katund i krishterë dhe kishte pasur 35 shtëpi prej të cilëve kishin mbetur vetëm 5 shtëpi. Në Tetovë kishte 20 shtëpi bullgare nga ky katund. Shqiptarët ishin të fiseve Vishovë dhe Hajdarë, që, sipas autorit, kishin ardhur nga Prishtina dhe Nishi. Këtu kishte qenë shumë e shprehur tradita e vëllazërimit të myslimanëve dhe të krishterëve.

Gllloboçica - Katund shqiptar, që gjendet pranë Lubotenit, ku banorët merreshin me bujqësi, blegtori dhe shitjen e drurit. Prodhoheshin grurë dhe molla cilësore, deri 80 tonelata mollë gjatë një viti. Autori thotë se katundi dikur kishte qenë vetëm i krishterë. Aty jetonin aty pjesëtarët e dy fiseve: Ceka të ardhur nga Dukagjini me 30 shtëpi Luma me 33 shtëpi dhe Dogja me 18 shtëpi.

Strazha - Katund shqiptar, që kishte qenë dikur i krishterë. Gjendet përballë Lubotenit, i vendosur në vendin e quajtur Bukovik. Banorët merreshin me bujqësi dhe shitjen e drurit. Sipas autorit, shqiptarët këtu kishin ardhur para 100 vitesh, gjegjësisht Bulicët nga Prizreni dhe Likët nga Dukagjini. Të gjithë shqiptarët ishin prej këtyre dy fiseve. Fisi i Bulicëve kishte dy shtëpi dhe Likët 17 shtëpi. Katundi ishte i ndarë në dy lagje. Në secilën prej tyre jetonin fiset e veçanta.

Kotlina - Katund shqiptar. Çiflig. Shqiptarët, sipas autorit, kishin ardhur para 72 vitesh. Shqiptarët ishin të familjeve Lika dhe Gjura, kurse një pjesë e sllavëve ishin shpërngulur në Jegunovcë.

Ivaja – Katund ku prodhohej shumë material druri, veçmas samarë për kuaj. Banorët merreshin me blegtori dhe bujqësi. Ishte katundi më i largët i kazasë së Tetovës, 7 orë larg Tetovës. Ndërmjet këtij katundi dhe Kotlinës kalonte rruga Tetovë - Prishtinë.

Goranca - Katund shqiptaro - bullgar ku kishte shumë drurë. Thuhet se dikur kishte qenë një katund i madh. Para luftës austriake - turke kishte pasur 30 shtëpi dhe 18 kisha. Pas shkatërrimit ishte ringjallur sërish. Autori, edhe për këtë katund, shkruan se shqiptarët kishin ardhur më vonë. Në këtë katund kishte fise shqiptare: Kaloshët, Kapetanët dhe Vilët.

Rezhanca – Vetëm thuhet se është katund shqiptar.

Kërveniku - Katund shqiptar ku banorët përshkruhen si *“shumë të egër dhe plaçkitës”*. Ata merreshin me bujqësi dhe blegtori. Veçmas me ruajtjen e dhive. Për popullatën shkruan se dikur kishte qenë e krishterë. Autori shkruan se banorët e Kërvenikut *“ishin shumë armiqësor”*. I quan *“gjakpirës dhe shikim egër”*. Për ngrohje përdornin dru. Të rrallë ishin ata që vizitonin qytetin.

Seçishta - Katund shqiptar pranë Kërvenikut, i vendosur në vend fushor. Prodhonte shumë produkte ushqimore. Jepte grurë, fasule dhe pemë.

Cerova në Derven - Katund shqiptar, ku kishte rrënoja të një kishe të vjetër dhe varreza të krishtera.

Laskarca - Katundi më i largët i Tetovës, që kufizohet me kazanë e Shkupit. Thuhet se kishte një han.

Paniçari – Thuhet se gjendet çerek ore larg Laskarcës, ku prodhoheshin lugë. Banorët merreshin edhe me bujqësi.

Rahovica – Vetëm thuhet se ishte çerek ore nga Paniçari dhe aty prodhoheshin lugë.

Novo Sella e Dërvenit – Autori shkruan vetëm se gjendej çerek ore larg Rahovicës.

Merova – Gjendet vetëm se çerek ore larg katundit të mësipërm.

Rogla - Gjysmë ore larg katundit të mësipërm.

Kopaçindolli - Gjysmë ore larg katundit të mësipërm, ku banorët merreshin pak me bujqësi.

Çifliku - Gjysmë ore larg katundit të mësipërm.

Debërca - Çerek ore larg katundit të mësipërm, ku banorët merreshin edhe me bujqësi.

Grupçini - Katund në Derven, i cili dikur, sipas autorit, ishte i banuar me të krishterë që kishin ikur për shkakun e zullumeve të ushtrive dhe bashibozukëve, duke u vendosur në katundet e afërta. Autori shkruan se shqiptarët e këtij katundi kishin ardhur nga Dibra dhe Mati. Banorët merreshin me blegtori dhe bujqësi. Për shkak se toka ishte gurore bujqësia nuk ishte e zhvilluar. Katundet e Dërvenit si Paniçari, Kopaçindolli, Llarca, Debarca dhe Grupçini shumë dru për djegie në Tetovë.

Larca - Katund pranë Grupçinit ku banorët merreshin pak edhe me bujqësi.

Nerashti - Katund shqiptar. *“Banorët janë hajdutë të mëdhenj. Katundarët që kalojnë nëpër Dervenin e Poshtëm kanë shumë frikë të kalojnë nëpër këtë katund”*, i cili dikur ka qenë i krishterë. Aty ka qenë e njohur një këngëtare me emrin Nera, nga e cila e ka marrë emrin. Në Nerasht ishin të njohura tri lagje: Mëhalla e poshtme, që dikur kishte qenë e krishterë dhe quhej Deli Ahmed. Deli Ahmedi kishte qenë një trim shqiptar, që kishte ardhur aty me 30 veta. Mëhalla e mesme quhej Reç, ku jetonin fiset Reçani, Haxhovcët dhe Laliocët. Laliocët ishin me origjinë nga Reçi, kurse Haxhovcët nga Dibra. Mëhalla e tretë quhej *“Maxharët”*, kurse, sipas autorit, i pari i tyre kishte qenë një hungarez i cili qe vendosur aty nga koha e luftës austriake. Ai më pas ishte turqizuar. Kjo lagje kishte 10 shtëpi.

Punevci - Katund i krishterë në veri të Vardarit dhe në perëndim të Orashës dhe Nerashtit.

Jegunovca - Katund bullgaro - shqiptar pranë lumit Vardar, ku shpesh kishte përmytje.

Podbregu - Katund bullgaro - shqiptar, 20 minuta në perëndim të Jegunovcës, *“ku bullgarët ngjatin si robër të shqiptarëve dhe të çifligut”*. Jepte drithëra dhe kumbulla.

Jançishta - Katund në anën e majtë të lumit Vardar dhe çiflig. Profesionit i vetëm i banorëve ishte bujqësia.

Përlibishti – Ishte çiflig, i vendosur në rrafshinë, pranë Vardarit.

Shemshova - Katund bullgaro - shqiptar, ku pranë tij ishte një çiflig. Prodhonte shumë produkte ushqimore.

Zhilca - Katund bullgar dhe çiflig.

Rataja - Çiflig që kishte një kishë të vjetër.

Ozurmishi - Katund që dikur kishte qenë shumë i madh, por kishte numri i banorëve kishte rënë shumë. Ishte çiflig.

Treboshi - Katund bullgaro - rom, në verilindje të Tetovës. Ishte çiflig dhe ndahej në dy pjesë: Treboshi i Madh dhe i Vogël.

Siriçina - Katund pranë Vardarit, ku kishte një urë të dobët druri. Ishte çiflig dhe kishte një kishë të vjetër.

Raotina - Katund në breg të lumit Vardar që kishte një urë druri.

Kopanica - Çiflik. Kultivohej misri më i mirë. Kishte një kishë të vjetër.

Tudenca - Katund pranë Vardarit. Prodhohet konopi, lini dhe gruri i cilësisë më të lartë.

Saraçina - Katund pranë Vardarit që prodhonte shumë konop dhe kishte një urë druri.

Radusha - Përshkruhet si katund ku banorët merreshin me kultivimin e duhanit. Ky katund thuhet si ishte djegur tërësisht në vitin 1888 dhe ishte rindërtuar sërish. Prodhohet shumë konopi, lini, misri dhe gruri. Fusha ishte shumë cilësore dhe prodhonte edhe elb, tërshërë, preshe, groshë dhe shalqinj. Kishte shumë livadhe të bukura. Njerëzit merreshin me bujqësi dhe shumë pak njerëz shkonin në kurbet.

Zhelina - Katund pranë Vardarit ku kishte një urë guri. Këtu kalonte rruga për në Shkup.

Strimnica - Katund *“i vendosur në Golo Brdo”*. Mbi katund kishte varreza dhe rrënoja të një kisha të vjetër.

Leshnica e Poshtme - Katund bullgaro - shqiptar, ku kishte rrënoja të një kisha të vjetër.

Leshnica e Epërme - Katund i pastër shqiptar *“me pamje shumë të bukur”*. Njerëzit merreshin me bujqësi, kurse blegtoria ishte kryesore.

Çellopeku - Katund bullgaro – shqiptar, ku banorët shkonin shumë në kurbet, veçmas në Shkup. Kishte shumë vreshta të mira. Ndërmjet Çellopekut dhe Leshnicës kishte qenë katundi Lipjan, ku kishte shumë dru bliri. Katundet përreth, sipas autorit, ishin krijuar me ardhjen e turqve nga Manastiri, nga njëra anë dhe Kosova, nga ana tjetër. Krerët e këtyre viseve kishin shkuar në Manastir dhe e kishin lutur Kara Mustafa Pashën e Manastirit që të vinte në Tetovë. Ai rrëfen një legjendë: kur banorët i kishin parë turqit mbi katund kishin thirrur: Turqit! Prej atëherë kishte mbetur emërtimi Turçani, kurse murgeshat e manastirit kishin hedhur florinj të dhe kështu kishte mbetur emërtimi Florina. Lipjani dhe Kleva ishin pa banorë.

Miletina - Katund ku popullata bullgare ishte zhvendosur me të madhe në Tetovë.

Billaca - Katund ku kishte shumë banorë që shkonin në kurbet, kurse të tjerët merreshin me poçari. Ata prodhonin enë të ndryshme dhe shumë cilësore. Ky ishte i vetmi vend ku banorët merreshin me këtë zanat. Produktet i shitnin në Tetovë dhe në Shkup.

Tenova - Katund ku kishte gërmadha të një manastiri të vjetër. Banorët më së shpeshti shkonin në kurbet në Shkup. Të tjerët ishin rrobaqepës, kurse një pjesë merreshin me përpunimin e bozës.

Stençja - Katund me fushë shumë pjellore. Banorët shkonin shumë në kurbet. Aty nuk kishte shtëpi

pa kurbetçinj. Turqit e quanin Sençe. Pranë tij ishte Falishti, një çiflig i teqesë së Tetovës. Ky vend ishte blerë nga banorët e Stençës dhe Volkovisë.

Volkovia - Katund bullgaro - shqiptar, ku kishte fushë shumë pjellore. Dikur kishte qenë shumë i pasur, por kishte shënuar rënie ekonomike, prandaj banorët shkonin në kurbet. Si shkak kryesor, sipas autorit, kishte qenë zullumi prej shqiptarëve dhe spahinjve, që ua merrnin gjysmën e grurit. Shumë banorë ishin zhvendosur në Tetovë dhe një pjesë ishin në kurbet. Pranë mureve të një manastiri të vjetër, mbledheshin njerëzit për festën e Shën Gjergjit. Aty kishte qenë edhe Patriarku bullgar.

Lukovica - Katund në juglindje të Volkovisë, ku banorët merreshin blegtori.

Sema - Katund që ishte i njohur për prodhimin e lugëve prej druri.

Çegrani - Katund ku kishte shumë burime.

Gurgurnica – Vetëm thuhet se ishte katund malor.

Forina - Katund bullgaro - shqiptar, ku kishte një kishë që quhej "Shën Nikolla". Kjo dëshmonte, sipas autorit, se katundi kishte qenë i krishterë. Autori supozon se këtu kishte pasur vetëm tri shtëpi shqiptare. Historia e katundit lidhej me emrin e Sinan Dregaliut, i fisit Kesexhiu.

Çajla - Katund bullgaro - shqiptar në Gostivar, ku kishte kishë dhe xhami. Banorët shqiptarë përshkruhen si "*hajdutë të mëdhenj*". Shqiptarët, shkruan ai, ishin të ardhur: Lurët nga Mirdita, kurse Çajanët nga katundi Çae, që kishte qenë në Malin Sharr, pranë Jelovjanit. Lurjanët, sipas autorit, kishin ardhur si bashibozukë. Ai shkruan se pjesëtarët e fisit Katanxhinjtë nga Lura, që ishin katolikë, vazhdonin t'i vizitonin pjesëtarët e fisit të tyre në Çajlë, të cilët "*ishin turqizuar*". Shqiptarët e këtij katundi e pëlqenin shumë gjizën dhe qepën, që ishin ushqimi i adhuruar, siç ishte për turqit pilafi dhe bakllavaja. Së këndejmë kish mbetur edhe thënia: "*Gjizë e qepë dhe asgjë tjetër*". Autori shkruan se banorët e krishterë, ashtu sikurse edhe shqiptarët, ishin të vendosur më vonë. Të krishterët ishin të ardhur nga Serbia. Me gjasë po të deklaroheshin si bullgarë do t'i përshkruante si vendorë. Në Çajlë kishte pasur kulla për roje dhe kishte qenë rruga e vjetër nga Shkupi drejt Ohrit nëpërmjet Kërçovës. Aty kishte ekzistuar vendbanimi Klevë. Emrin Çajlë e kishte nga çajanët, që kishin jetuar në Çae. Kleva kishte qenë katund i madh, me 500 shtëpi, kurse në defterët perandorakë përmendej "*Fusha e Klevës*".

Korita - Katund që gjendet mbi Çajle dhe përveç ujit të puseve nuk kishte tjetër. Përreth kishte shumë drurë ahu dhe ujë të mirë. Ky katund dikur kishte qenë shumë i madh. Banorët kishin qenë qehaja, që kishin pasur deri 2000 krerë dhenë. Shpesh, që t'i iknin shërbimit ushtarak, u paguanin autoriteteve nga 50 lira turke. Shqiptarët ishin me origjinë nga Reka. Banorët kishin punuar në kurbet deri 20 vjet. Ata kishin shkuar në vise të ndryshme të botës: në Afrikë, Azi dhe Amerikë, kurse mijakët shkonin më Vllahi, Bullgari dhe Serbi. Në Bullgari kishte shumë njerëz inteligjentë që ishin ngjitur nëpër poste shumë të larta shtetërore, e megjithatë dëshironin që gruan ta kishin nga vendlindja. Banorët e Koritës ende vazhdonin të martoheshin vetëm me vajza nga Reka. Fiset vazhdonin të jepnin dhe merrnin nuse vetëm në Rekë. Koritasit kishin fise të tyre në Rekë dhe i ruanin lidhjet farefisnore. Korita ishte katund shumë i vjetër që dikur kishte qenë i krishterë. Për banorët e Rekës, autori thotë se ishin "*bullgarë të pastër*", prej të cilëve disa kishin mbetur të krishterë, kurse të tjerët ishin turqizuar nga presioni osman dhe kishin pranuar të bënin jetë të lirë dhe të dinjitetshme.

Balindolli - Përshkruhet si katund bullgar, ku kishte pasur një qytet të quajtur "Gradisht". Autori e kishte vizituar katundin i shoqëruar nga një prift. Fëmijët ishin tmerruar sapo e kishin parë priftin.

Kjo ndodhte sepse gratë, që t'i qetësonin fëmijët, trembnin ata duke u thënë se do të vinte prifti ose turku.

Turqani i Poshtëm ose i Madh - Katund bullgar që gjendej 20 minuta larg Balindollit, ku kishte shumë vreshta.

Turqani i Poshtëm ose i Vogël - Katund që gjendej çerek ore nga Turqani i Madh, njëra pjesë e të cilit quhej Llapushnik. Aty kishte ujë të ftohtë, kurse banorët e kishin zakon që të flladiteshin nën hijen e pemëve pranë lumit. Të gjithë banorët kishin tokë punuese pranë Vardarit. Aty ishte e zhvilluar bujqësia dhe shumë pak blegtoria, kurse banorët shkonin shumë në kurbet, por jo shumë larg nga Pollogu i Poshtëm. Më së shumti shkonin në Shkup, ku punonin si rrobaqepës ose bukëpjekës, kurse në vende më të largëta punonin si bozaxhinj dhe hallvaxhinj. Edhe pse administrativisht i takonte Tetovës, banorët më shumë udhëtonin në Gostivar, që e kishin më afër. Petrov shkruan se banorët e krishterë kishin përjetuar shumë zullume nga shqiptarët, prandaj shumë prej tyre ishin shpërngulur në Tetovë. Me këtë rast thotë se shqiptarët në Tetovë flisnin shumë mirë bullgarisht ashtu sikurse edhe bullgarët flisnin shqip. Ai i përshkruan edhe ritet e martesës që zakonisht bëheshin me surle dhe tupanë, por edhe me gajde. Gjithashtu i përshkruan edhe veshjet e shumta.

Kunova - Gjendet një orë larg Turqanit të Epërm, i vendosur në një luginë.

Tërnova - Në orë larg Kunovës, ku kishte një kishë të vjetër.

Qafa - Katund ku kishte një pyll të dendur.

Zheleza Reka - Gjysmë ore larg Qafës, i ndarë në disa lagje dhe i vendosur pranë një lumi.

Padalishti - Katund që banohej *"me turq që flasin shqip"*. *"Disa janë ardhacakë e disa janë bullgarë të turqizuar"*. Mbi Gostivar, në rrugën drejt Kërçovës, kishte një teqe, e ndërtuar prej një shehu me origjinë nga Çae. Të parët e Padalishtit ishin të krishterë, por ishin turqizuar nën ndikimin e teqesë.

Serbinova - Katund i vendosur pranë një lumi, ku kishte rrënoja të një manastiri të vjetër.

Llakaica - Katund pranë lumit me emër të njëjtë, çerek ore larg Gostivarit, ku ishin mbetjet e një kalaje të quajtur "Zvezdeno Kale" (Kalaja e Yllit). Pranë ishte nxjerrë mineral hekuri.

Mitroi kërst - Çerek ore larg Llakaicës, ku kishte një kishë të re.

Gjonoica - Katund pranë lumit me të njëjtin emër. Rreth tij kishte një pyll të dendur, plot me dru ahu, dushku, bliri etj. Në afërsi kishte gërmadha të një kishë të vjetër.

Simnica - Katund bullgaro - shqiptar ku prodhoheshin më shumë mjete bujqësore. Gjysmë ore pranë katundit kishte rrënoja të një vendbanimi të vjetër kur shqiptarët dhe bullgarët shkonin për Shën Gjergji.

Taimishta - Vetëm thuhet se gjendej një orë larg Simnicës.

Sredkova - Katund i vendosur pranë një vendi me shumë ah dhe dushk.

Cerova - Katund shqiptar, që gjendet çerek ore nga Sredkova.

Sushica - Përshkruhet si katund i vendosur pas qytetit të Gostivarit, ku kishte ujë të pakët. Pranë katundit ishin dy vende që dikur kishin qenë të banuar: Skakulica dhe Kuklishi.

Banjica e Epërme dhe e Poshtme - Katunde, me tokë shumë pjellore, që i ndante nga Gostivari vetëm lumi Vardar. Aty thuhet se kishte vende që shiteshin deri 20 lira. Për Banjicën thuhet se ishte një katund shumë i vjetër. Dikur, shkruan autori, ky katund kishte qenë shumë i madh, por pas ardhjes së turqve dhe luftës që kishin bërë kundër tyre, katundi ishte boshatisur. Vendi i betejës vazhdonte të quhej "Rudaic". Sipas gojëdhënave mbi këtë katund kishte pasur një manastir të madh. Autori shkruan se banorët që jetonin aty ishin të ardhur. Para shkatërrimit të katundit aty kishte qeverisur njëfarë Hasani.

Novo Sella Paprati - Katund me shumicë shqiptare. Përshkruhet si vend me shumë kullosa dhe me kushte shumë të mira për zhvillimin e blegtorisë, ndërkaq toka bujqësore nuk ishte e cilësisë së mirë. Për shqiptarët e këtij katundi autori thotë se ishin *"më të egrit dhe më të mallkuarit në Tetovë"*. Katundi përherë kishte shërbyer si urë për shqiptarët që të kalonin Sharrin dhe të shtriheshin në Malin e Thatë, në malet e Shkupit e deri në Veles. Ky, sipas autorit, mund të ishte shkaku përse banorët kishin *"një karakter prej plaçkitësi, ishin të egër, të frikshëm dhe të rrezikshëm"*.

Leunova - Përshkruhet si katund që gjendej katër orë larg Gostivarit, në jugperëndim të tij. Në këtë katund kishte një kishë.

Kifrova ose Nikiforova - Përshkruhet si katund pranë Leunovës.

Mavrova - Përshkruhet si katund bullgar, në fushën e Mavrovës, emri i të cilit, sipas autorit, kishte origjinë turke, që do të thoshte: *"vend ku nuk kishte asgjë dhe askënd nuk e pranonte mbi vete"*. Gjatë vitit jepje 200 lira për spahiu dhe 200 krerë bagëti për beun. Katundi ishte i ndarë në tetë lagje. Ishte pjesa më e largët e Tetovës në jugperëndimin dhe gjendet 10 orë larg. Banorët e lashtë të Mavrovës përshkruhen si shumë trima, që nuk pranonin asnjë qeverisje. Plaçkitësit e Mavrovës kishin qenë aq të fuqishëm sa kishin kryer grabitje edhe në Malësinë e Shqipërisë. Në këto veprime ndihmoheshin edhe nga malet. Ndër plaçkitësit më të njohur ishin ata të familjes Maiovci, që e kishin grabitur edhe një katund shqiptar në Malësi, por shumë shpejt ishin sulmuar nga shqiptarët. Katundi ishte boshatisur dhe banorët ishin dëbuar. Mbi Mavrovë gjendeshin Hanet e Mavrovës, përgjatë rrugës së Dibërës, ku toka bujqësore nuk ishte cilësore, kurse kushtet klimatike ishin shumë të papërshtatshme. Megjithatë, banorët ishin tepër të aftë për zhvillimin e blegtorisë dhe prerjen e drurit. Banorët shkonin shumë në kurbet, deri në Stamboll, ku punonin si leblebixhinj, shitës qumështi, bukëpjekës, pronar kafeneshë etj. Këto vende përshkruhen si shumë të rrezikshme për shkak të çetave shqiptarë. Thuhet, gjithashtu, se banorët e këtyre viseve kishin shumë dëshirë që të zbukuroheshin.

Dufi - Përshkruhet si katund ku *"bullgarët flasin shqip dhe vetëm të rriturit dinë bullgarisht"*, kurse në kishë i ndiqnin ritet sllave. Banorët kishin karakter malësori. Autori i përshkruan edhe lagjet e këtij katundi, më të largët të Tetovës, në jugperëndim, gjegjësisht 10 orë larg. Banorët merreshin me blegtori, që ishte burimi kryesor i ekzistencës dhe kishin vetëm pak tokë bujqësore. Kishte kurbetçarë që shkonin deri në Stamboll. Banorët e Dufit martoheshin me katundet përreth.

Ortutsi - Katund që gjendet një orë larg Dufit, pranë lumit Melc. Kishte një urë druri dhe një pyll me dru ahu dhe dushku.

Reçani – Përshkruhet vetëm si katund gjysmë orë larg Melcit.

Vrutoku - Katund që gjendet mbi burimet e Vardarit, pas Zendel Begut, në jugperëndim të katundit Duf. Aty kishte një xhami dhe një kishë. Vendi i vjetër quhej Selishtë, ku sipas autorit, mund të kishte qenë katundi i vjetër.

Petrovi, në këtë studim, disa katunde vetëm i përmend por nuk jep të dhëna, sikurse: Zdunjin, Jelovcin e Poshtëm dhe të Epërm, Pallçishtin, Vrapçishtin, Gallatën, Lisecin dhe Gajrën. Nuk përmenden dhe as nuk jepet të dhëna për katundet e Malësisë, sikurse: Shipkovica, Vica, Veshalla, Bozovca apo katundet sikurse: Bogovina, Piroku apo Reçica.